

Albanian



Udhëzime për përdorimin e duhur të antibiotikëve

(Guide to Wise Use of Antibiotics)

Menaxhimi i kollës, ftohjeve, teshtimave dhe mikrobeve
(Managing Coughs, Colds, Sneezes & Germs)

**A kanë
nevojë
bakteret ?
për ilace**

 Alberta Health
Services

Ky burim ofrohet gjithashtu në përktimet vijuese: (This resource is also available in the following translations:)

- Blekfut
- Kriisht
- Dënesųtné
- Stoney

- Arabisht
- Bengalisht
- Kinezisht
- Frëngjisht
- Hindisht
- Koreanisht
- Malajalamisht
- Oromisht
- Pashtoisht
- Persisht
- Punjabisht
- Somalisht
- Spanjisht
- Suahilisht
- Tagalogisht
- Tigrinjisht
- Ukrainisht
- Urduisht
- Vietnamisht

"Do Bugs Need Drugs", Kontrolli i Sëmundjeve të Transmetueshme, Alberta Health Services.

DBND@ahs.ca

www.dobugsneeddrugs.org

© 2022 Alberta Health Services,

Shëndeti i popullsisë, publik dhe provincial



Kjo punë është e licencuar sipas licencës ndërkombëtare **Creative Commons Attribution-Non-commercial-Share Alike 4.0**. Për të parë një kopje të kësaj licence, shikoni **<https://creativecommons.org/licenses/by-nc-sa/4.0/>**. Jeni të lirë të kopjoni, shpërndani ose të përshtatni punën për qëllime jotregtare, për sa kohë ia atribuoni punën "Alberta Health Services" dhe respektoni kushtet e tjera të licencës. Nëse e ndryshoni, transformoni ose e zhvilloni këtë punë, mund ta shpërndani punën rezultuese vetëm sipas një licence të ngjashme, të njëjtë ose të pajtueshme. Licenca nuk vlen për markat tregtare, logot ose përmbajtjet e AHS për të cilat "Alberta Health Services" nuk është zotërues i të drejtës së autorit.

Deklarata e mohimit të përgjegjesisë: (Disclaimer statement:)

Ky material ka si qëllim të ofrojë informacione të përgjithshme dhe ofrohet mbi bazën "siç është", "aty ku është". Pavarësisht përpjekjeve të arsyeshme për të konfirmuar saktësinë e informacionit, "Alberta Health Services" nuk përbën asnjë përfaqësim ose garanci, të shprehur, të nënkuptuar ose ligjore, për sa i përket saktësisë, besueshmërisë, plotësisë, zbatueshmërisë ose përshtatshmërisë për një qëllim të caktuar të një informacioni të tillë. Ky material nuk është zëvendësues i këshillave të një profesionisti të kualifikuar të shëndetit. "Alberta Health Services" mohon shprehimisht të gjitha përgjegjësitë për përdorimin e këtyre materialeve dhe për çdo pretendim, veprim, kërkesë ose padi që rrjedh nga ky përdorim.

A kanë nevojë bakteret për ilace

(Do Bugs Need Drugs)

Rezistenca ndaj antibiotikëve (Antibiotic Resistance)	2
Larja e duarve (Handwashing)	4
Bakteret dhe viruset (Bacteria & Viruses)	6
Ethet (Fever)	7
Ftohjet dhe rrjedhjet e hundëve (Colds & Runny Nose)	8
Gripi (Influenza)	10
Infeksioni i sinusit (Sinus Infection)	12
Dhimbja e fytit (Sore Throat)	14
Dhimbja e veshit (Ear Ache)	16
Kolla (Cough)	18
Simptomat serioze që duhen kontrolluar nga një profesionist mjekësor	20
(Serious Symptoms That Should be Seen by a Medical Professional)	
Shenjat e emergjencave shëndetësore (Signs of Health Emergencies)	22

Rezistenca ndaj antibiotikëve (Antibiotic Resistance)

Çfarë është rezistenca ndaj antibiotikëve? (What is antibiotic resistance?)

- **Përdorimi i antibiotikëve**, qoftë për arsytet e duhura ose të gabuara, mund të çojë në rezistencën ndaj antibiotikëve. Për të kufizuar zhvillimin e rezistencës ndaj antibiotikëve, **antibiotikët duhet të përdoren vetëm nëse është e nevojshme.**
- Rezistenca ndaj antibiotikëve është një mekanizëm mbrojtës i bakteve që i lejon ata të jetojnë dhe të shumohen, edhe kur një antibiotik është i pranishëm. Bakteret që kanë rezistencë ndaj antibiotikëve shpeshherë quhen **“superbaktere”**.
- Kur bakteret kanë rezistencë ndaj antibiotikëve, antibiotikët që kanë funksionuar dikur nuk funksionojnë më.
- Infeksionet e shkaktuara nga bakteret rezistente ndaj antibiotikëve janë të vështira dhe ndonjëherë të pamundura për t'u trajtuar. Kjo mund të rezultojë në sëmundje afatgjata dhe ndoshta në vdekje.
- Kini parasysh, bakteret janë rezistente - JO JU! Edhe njerëzit e shëndetshëm që nuk kanë marrë kurrë antibiotikë mund të infektohen me bakte rezistente ndaj antibiotikëve nga burime të tjera.

Antibiotikët nuk të ndihmojnë për infeksione virale, si ftohjet, gripi dhe bronkiti (ftohje në kraharor).

Përdorimi i antibiotikëve për këto infeksione mund të çojë në rezistencën ndaj antibiotikëve.

Çfarë duhet të bëni? (What should you do?)

- **Mos merrni** antibiotikë kur ju ose fëmija juaj ka kollë ose ftohje. Shumica e këtyre infeksioneve shkaktohen nga viruse dhe antibiotikët nuk ndihmojnë.
- Flisni me mjekun tuaj nëse infeksioni është viral apo bakterial dhe nëse nevojiten antibiotikë.
- Jini të durueshëm kur ju (ose fëmija juaj) keni simptoma të ftohjes, kollës ose dhimbje fyti. Sëmundjet më virale zgjasin 4-5 ditë përpara se të ndiheni më mirë dhe deri në 3 javë për shërim të plotë.
- Gjatë sezonit të gripit ose ftohjes, lani duart rregullisht për të parandaluar sëmundjen. Ndiqni këshillat tona të detajuara për larjen e duarve në faqen tjetër.

**Shmangni betejën me një
BAKTER SUPER REZISTENT.
Përdorini antibiotikët në
mënyrën e duhur!**


Larja e duarve

(Handwashing)

*Larja e duarve është mënyra më e mirë për të ndaluar përhapjen e infeksioneve. **80% e infeksioneve mund të përhapen përmes duarve.***

Kur duhet t'i lani duart: **(When to wash your hands:)**

- Para vakteve
- Para, gjatë dhe pas përgatitjes së ushqimit
- Para ushqyerjes me gji
- Pas përdorimit të tualetit ose pasi keni ndihmuar një fëmijë të përdorë tualetin
- Para ose pas ndërrimit të pelenave ose produkteve të higjienës personale femërore
- Pas shfryrjes së hundëve ose fshirjes së hundës së një fëmije
- Pas prekjes së objekteve që i kanë pasur dhe të tjerët
- Para se të vendosni ose të hiqni lentet e kontaktit
- Para dhe pasi të kujdeseni për dikë që është i sëmurë
- Pas prekjes së kafshës ose ushqimit të tyre ose pas mbajtjes së mbetjes së kafshës
- Para dhe pas pastrimit të dhëmbëve



Si t'i lani duart: (How to wash hands:)

1. Përdorni ujë dhe sapun. Larja vetëm me ujë nuk i largon mikrobet.
2. Lagni duart.
3. Përdorni sapun të thjeshtë. **Mos përdorni sapun antibakterial.**
4. Fërkoni duart bashkë për 20 sekonda (ose për aq kohë sa duhet për të kënduar *Vezzullo, vezullo yll i vogël*). Fërkoni gjithë pjesët e duarve duke përfshirë pëllëmbët, mes gishtave, gishtat e mëdhenj, sipër duarve, kyçet, majat e gishtave dhe thonjtë.
5. Shpëlani duart për 10 sekonda.
6. Thajini duart mirë me një peshqir të pastër.



Çfarë duhet të bëni: (What you should do:)

- Prisni që mjekët, dentistët, infermierët dhe terapistët t'i lajnë duart përpara se të kontrollojnë fëmijën tuaj.
- Sigurohuni që të ketë sapun të thjeshtë në tualetin e shkollës së fëmijës tuaj dhe në vendin tuaj të punës.
- Sigurohuni që qendrat e kujdesit për fëmijët të kenë vende ku të rriturit dhe fëmijët mund të lajnë duart.
- **Përdorni sapun të thjeshtë.** Sapuni i thjeshtë funksionon po aq mirë sa sapuni antibakterial. Sapuni antibakterial nuk rekomandohet sepse çon në rezistencë bakteriale dhe nuk është më efektiv se sapuni i thjeshtë.
- Mësoni nga shembulli.

Bakteret dhe viruset

(Bacteria & Viruses)

Si viruset ashtu edhe bakteret shkaktojnë infeksione, por antibiotikët veprojnë vetëm kundër baktereve.

Infeksionet virale (Viral infections)

- Përfshijnë ftohjen, gripin, mykun, laringitin, ftohjet në kraharor (bronkit), dhe më së shumti dhimbjet e fytyrës.
- Zakonisht janë më ngjitëse se infeksionet bakteriale. Nëse më shumë se një person në familje ka të njëjtën sëmundje, ka shumë të ngjarë të jetë infeksion viral.
- Mund t'ju sëmure po aq sa infeksionet bakteriale.
- Zakonisht e merrni veten për 4-5 ditë, por mund të duhen deri në 3 javë për t'u shëruar plotësisht.

✗ Antibiotikët nuk funksionojnë për infeksionet virale

Infeksionet bakteriale (Bacterial infections)

- Janë më pak të zakonshme se infeksionet virale.
- Nuk përhapen aq lehtë si infeksionet virale, nga një person te tjetri.
- Shembuj të ngjashëm përfshijnë streptokokun e fytyrës dhe disa lloje të pneumonisë.

✓ Antibiotikët funksionojnë për infeksionet bakteriale, por nuk janë gjithmonë të nevojshme

Ethet (Fever)

Ethet janë temperatura e lartë e trupit, shpesh për shkak të sëmundjes. Lëkurë e skuqur, e nxehtë dhe e thatë, madje edhe poshtë sqetullave, është një shenjë ethesh.

Temperatura juaj ose temperatura e fëmijës tuaj varet nga pjesa e trupit ku matet.



Për një listë të simptomave që duhet të vlerësohen nga një profesionist mjekësor, shkoni në faqen 20. Për një listë të simptomave që janë të rrezikshme dhe që kërkojnë kujdes të menjëhershëm mjekësor, shkoni në faqen 22.

Menaxhimi: (Management):

- Ethet përbëjnë një mekanizëm mbrojtës që ndihmon trupin të luftojë infeksionin. Ethet mund të shfaqen me infeksione virale dhe bakteriale.
- Konsideroni përdorimin e paracetomolit ose ibuprofenit (sipas udhëzimeve në paketim) nëse personi me ethe nuk ndihet mirë.
- Vishni veten ose fëmijën tuaj me veshje të lehta në mënyrë që të jeni të freskët, por jo të dridheni nga i ftohti, pasi dridhja gjeneron më shumë nxehtësi. Mbajeni temperaturën e dhomës rreth 20°C ose të freskët aq sa duhet.
- Pini shumë lëngje të freskëta. Jepini fëmijës tuaj lëngje të freskëta ose akullore çdo orë kur është zgjuar.

Ethet: (Fever:)

- Ndihmojnë trupin të luftojë infeksionin
- Mund të shfaqen me infeksione virale dhe bakteriale

Nëse një person i çdolloj moshe ka ethe dhe skuqje dhe ka qenë në një zonë ku qarkullon fruthi, kontaktoni Health Link (telefononi 811 në Alberta) për të marrë këshilla për mënyrën më të mirë të veprimit.

Ftohjet dhe rrjedhjet e hundëve

(Colds & Runny Nose)



Ftohjet shkaktohen nga viruset. Janë rreth 200 viruse të ndryshme që shkaktojnë ftohjet. Fëmijët mund të kalojnë 8-10 ftohje në vit. Të rriturit kalojnë më pak ftohje sepse kanë krijuar imunitet ndaj disa prej viruseve. Antibiotikët nuk veprojnë kundër viruseve të ftohjes.

Simptomat: (Symptoms:)

- Në fillim keni dhimbje koke, ethe dhe lotim të syve, e ndjekur nga rrjedhje hundësh, dhimbje të fytit, teshtitje dhe kollë.
- Lëngu nga hunda është transparent në fillim, por më vonë trashet në ngjyrë të verdhë ose jeshile.

Menaxhimi: (Management:)

- Pini shumë ujë, në cilëndo temperaturë që është më e përshtatshme.



Për një listë të simptomave që duhet të vlerësohen nga një profesionist mjekësor, shkoni në faqen 20. Për një listë të simptomave që janë të rrezikshme dhe që kërkojnë kujdes të menjëhershëm mjekësor, shkoni në faqen 22.



Parandalimi: (Prevention:)

- Lani duart për të parandaluar përhapjen e viruseve që shkaktojnë ftohjet.
- Mësoni fëmijët tuaj të lajnë duart.

- Konsideroni përdorimin e paracetomolit ose ibuprofenit (sipas udhëzimeve në paketim) nëse personi me të ftohtë nuk ndihet mirë.
- Nëse jeni të ftohur ose po kujdeseni për dikë me ftohje, lani duart shpesh për të parandaluar infektimin e të tjerëve.
- Një dekonjestant ose shurup për kollë mund të ndihmojë në lehtësimin e simptomave, por nuk do të shkurtojë kohën e ftohjes.

SHËNIM: Mos ua jepni këto produkte foshnjave ose fëmijëve nën moshën gjashtë vjeç.

SHËNIM: Dekonjestantët dhe shurupi për kollë mund të përmbajnë gjithashtu mjekim për uljen e temperaturës. Lexoni me kujdes etiketat dhe konsultohuni me farmacistin ose mjekun tuaj për të shmangur mbidozën.

Përdorni ujë me kripë (saline) në formë pikash për të trajtuar bllokimin, veçanërisht për fëmijët dhe foshnjat. Përdorni ujë me kripë të blerë që hidhet me pika ose spërkatës ose **përgatiteni vetë.**

Ujë me kripë i bërë në shtëpi që hidhet me pika (Homemade Salt Water Drops)

Përzierja bashkë:

(Mix together:)

- 1 filxhan (240 ml) ujë të distiluar (nëse përdorni ujë rubineti, zieni për një minutë për ta sterilizuar fillimisht dhe më pas ftohni derisa të bëhet i vakët)
- ½ luge çaji (2,5 g) kripë
- ½ luge çaji (2,5 g) sodë buke

Vendoseni tretësirën në një shishe të pastër me pikatore, ose në një shishe që shtrydhet (gjendet në farmaci). Mund të përdorni edhe një shiringë nazale. Përgatisni një tretësirë të freskët çdo 3 ditë.

Përdorimi:

(To use:)

- Uluni dhe anoni pak kokën mbrapa. Mos u shtrini. Vendosni majën e pikatores, shiringën nazale ose shtrydheni shishen pak në brendësi të hundës. Pikoni butësisht ose hidhni disa pika në vrimë të hundës. Përsëriteni për vrimën tjetër të hundës. Fshini pikatoren me një leckë ose pecetë të pastër pas çdo përdorimi.

Gripi (Influenza)



Gripi shkaktohet nga një virus. Të rriturit me grip mund ta përhapin virusin te të tjerët për 3-5 ditë pas nisjes së simptomave. Fëmijët me grip mund ta përhapin virusin te të tjerët për deri në 7 ditë.

Simptomat: (Symptoms:)

- Ethe/të dridhura
- Dhimbje koke
- Dhimbje trupi ose muskujsh
- Ndiheni të lodhur
- Dhimbje fyti
- Rrjedhje ose bllokim hundësh/teshtima
- Kollë



Për një listë të simptomave që duhet të vlerësohen nga një profesionist mjekësor, shkoni në faqen 20. Për një listë të simptomave që janë të rrezikshme dhe që kërkojnë kujdes të menjëhershëm mjekësor, shkoni në faqen 22.



Parandalimi: (Prevention:)

- Bëni vaksinën vjetore kundër gripit.
- Lani duart, veçanërisht pasi takoni dikë që është i sëmurë. Mësoni fëmijën tuaj për larjen e duarve.
- Mbuloni hundën dhe gojën kur teshtini ose kolliteni.
- Mësoni fëmijën tuaj të përdorë rregullat e higjienës respiratore.

Menaxhimi: (Management:)

- Pini shumë lëngje, si p.sh., ujë.
- Pushoni shumë ose lëreni fëmijën të pushojë shumë.
Qëndroni në shtëpi ose mbajeni fëmijën tuaj në shtëpi për ditët e para të sëmundjes për të pushuar dhe për të parandaluar përhapjen te të tjerët.
- Konsideroni përdorimin e paracetomolit ose ibuprofenit (sipas udhëzimeve në paketim) për ethe, dhimbje koke dhe dhimbje trupi.

Sezoni i gripit fillon zakonisht në nëntor ose dhjetor të çdo viti dhe përfundon në prill ose në maj. Herë pas here, gripit mund të çojë në pneumoni.

Infeksioni i sinuseve (Sinus Infection)



Sinuset janë hapësira të mbushura me ajër rreth hundës dhe syve. Sinusiti ndodh kur krijohen lëngje në sinuse.

Sinusiti shfaqet më shpesh pas një ftohjeje, por shumica e ftohjeve nuk çojnë në sinusit bakterial. Simptomat e sinusitit janë më të rënda dhe zgjasin më shumë se ftohja

SHËNIM: Nëse simptomat shoqërohen me dhimbje të fytit dhe/ose kollë, shikoni seksionin Ftohjet dhe/ose Gripi.

Simptomat: **(Symptoms:)**

- Dhimbje ose presion në fytyrë, dhimbje koke, dhimbje dhëmbi, ndjenjë lodhjeje, kollë, ethe.
- Hunda e bllokuar me sekrecione nazale në ngjyrë të verdhë ose jeshile që zgjat më shumë se 10 ditë është shenjë se mund të keni nevojë për antibiotikë.



Për një listë të simptomave që duhet të vlerësohen nga një profesionist mjekësor, shikoni në faqen 20. Për një listë të simptomave që janë të rrezikshme dhe që kërkojnë kujdes të menjëhershëm mjekësor, shikoni në faqen 22.

Menaxhimi: (Management:)

- Konsideroni përdorimin e paracetomolit ose ibuprofenit (sipas udhëzimit në paketim) për dhimbje ose ethe.
- Për fëmijët, përdorni pika ose spërkatës me ujë të kripur për të ndihmuar në lehtësimin e sekrecioneve të hundës (shikoni seksionin Ftohjet/rrjedhja e hundëve për recetën në faqen 9); për të rriturit, lagia me ujë të kripur është më efektive.
- Dekongestantët mund të lehtësojnë bllokimin, por nuk do shkurtojnë kohëzgjatjen e sëmundjes.

SHËNIM: Mos ua jepni këto produkte foshnjave ose fëmijëve nën moshën gjashtë vjeç.

SHËNIM: Dekongestantët mund të përmbajnë gjithashtu mjekim për uljen e temperaturës. Lexoni me kujdes etiketat dhe konsultohuni me farmacistin ose mjekun tuaj për të shmangur mbidozën.

Si bakteret ashtu edhe viruset mund të shkaktojnë sinusit (viruset janë 200 herë më të zakonshme).

Dhimbja e fytit

(Sore Throat)



Dhimbja e fytit shoqërohet shpesh me ftohje. Shumica e dhimbjeve të fytit shkaktohen nga viruset. Një antibiotik nuk ndihmon në lehtësimin e dhimbjes së fytit të shkaktuar nga një virus.

Disa dhimbje të fytit shkaktohen nga bakteri Streptokok. Nëse dhimbja e fytit shoqërohet me rrjedhje të hundës, kollë, zë të ngjirur, skuqje e syve ose diarre, ka të ngjarë që është shkaktuar për shkak të një virusi dhe JO nga streptokoku i fytit.

Mjeku nuk mund ta dallojë vetëm duke e parë me sy nëse dhimbja e fytit është shkaktuar nga streptokoku i fytit.

- Nëse dhimbja e fytit është pjesë e një ftohjeje, ka shumë të ngjarë të shkaktohet nga një virus dhe nuk nevojitet një tampon fyti.
- Nëse nuk keni shenja të ftohjes, mjeku juaj mund të marrë një mostër me një tampon fyti për të përcaktuar nëse dhimbja e fytit shkaktohet nga një bakter apo virus. Rezultatet e testit zakonisht dalin brenda 48 orëve.



Për një listë të simptomave që duhet të vlerësohen nga një profesionist mjekësor, shkoni në faqen 20. Për një listë të simptomave që janë të rrezikshme dhe që kërkojnë kujdes të menjëhershëm mjekësor, shkoni në faqen 22.

- Nëse rezultatet e testit janë negative, antibiotikët nuk do të funksionojnë sepse ka të ngjarë që dhimbja e fytit të shkaktohet nga një virus.
- Nëse rezultatet e testit janë pozitive, mjeku juaj mund të vendosë t'ju japë një antibiotik me recetë.
- Anëtarët e tjerë të familjes nuk kanë nevojë të testohen nëse nuk janë të sëmurë.

Menaxhimi: (Management:)


- Pini shumë lëngje, si p.sh., ujë.
- Konsideroni përdorimin e paracetomolit ose ibuprofenit (sipas udhëzimeve në paketim) për dhimbje fyti dhe ethe.
- Për fëmijët e moshës gjashtë vjeç e lart dhe të rriturit, tabletat e thjeshta të fytit mund të lehtësojnë simptomat.

SHËNIM: Fëmijëve më të vegjël nuk duhet t'u jepen tableta për shkak të rrezikut të mbytjes.

- Për fëmijët më të mëdhenj dhe të rriturit, gargara me ujë të ngrohtë e të kripur do ta bëjë fythin të ndihet më mirë. Përzieni $\frac{1}{2}$ lugë çaji me kripë kokërr me 1 filxhan (250 ml) ujë të ngrohtë. Bëni gargarë për 10 sekonda. Mund të bëhet 4-5 herë në ditë.
- Ju ose fëmija juaj mund të ktheheni në aktivitetin normal kur të ndiheni më mirë.

Dhimbja e veshit

(Ear Ache)



Tubi Eustachian lidh veshin e mesëm dhe pjesën e pasme të fytit. Për shkak se ky tub është i ngushtë te fëmijët e vegjël, mund të bllokohet sidomos me një ftohje. Ky bllokim mund të çojë në infeksion.


Është e rëndësishme të theksohet se 70-80% e fëmijëve që kanë infeksion të veshit përmirësohen pa një antibiotik. Disa infeksione të veshit ndodhin për shkak të viruseve dhe disa të tjera për shkak të baktereve. Kujdesi i vazhdueshëm është një qasje e arsyeshme që mund të rekomandojë mjeku juaj.



Për një listë të simptomave që duhet të vlerësohen nga një profesionist mjekësor, shkoni në faqen 20. Për një listë të simptomave që janë të rrezikshme dhe që kërkojnë kujdes të menjëhershëm mjekësor, shkoni në faqen 22.

Simptomat: (Symptoms:)

- Ethe
- Dhimbje veshi
- Nervozizëm



Menaxhimi: (Management:)

- Konsideroni përdorimin e paracetomolit ose ibuprofenit (sipas udhëzimit në paketim) për dhimbje ose ethe.
- Vendosni një leckë të ngrohtë mbi pjesën e jashtme të veshit.
- Antihistaminat dhe dekongestantët nuk ndihmojnë në shërimin e infeksionit të veshit.
- Në rrethana të caktuara, mjeku mund të japë antibiotikë me recetë pas kontrollit të veshëve të fëmijës tuaj.
- Për shkak të rrezikut të rezistencës ndaj antibiotikëve, nuk rekomandohet më dhënia e antibiotikëve për periudha të gjata për parandalimin e infeksioneve të veshit.



Parandalimi: (Prevention:)

- Lani duart shpesh dhe mësoni fëmijën tuaj për larjen e duarve pasi shumica e infeksioneve të veshit vijnë pas ftohjes.
- Shmangni ekspozimin e fëmijës tuaj ndaj ambienteve ku lejohet duhani.
- Mos i jepni fëmijës tuaj një shishe për të pirë kur është shtrirë.

Kolla (Cough)

Shumica e kollës të rriturit dhe fëmijët shkaktohet nga infeksionet virale të traktit respirator (shikoni grafikun më poshtë). Antibiotikët duhet të përdoren për kollë vetëm nëse pacienti ka pneumoni për shkak të baktereve ose nëse ka rezultuar pozitiv për pertusis (kollë e mirë).



Për një listë të simptomave që duhet të vlerësohen nga një profesionist mjekësor, shikoni në faqen 20. Për një listë të simptomave që janë të rrezikshme dhe që kërkojnë kujdes të menjëhershëm mjekësor, shikoni në faqen 22.

Simptomat: (Symptoms):

- Ethe, kollë dhe dhimbje kraharori.
- Kollitje me mukozë që mund të jetë e verdhë ose jeshile. Kjo nuk do të thotë se është një infektion bakterial.
- Mund të shoqërohet dhe me vështirësi në frymëmarrje.

SHËNIM: Me bronkit akut, 45% e njerëzve kanë ende kollë pas 2 javësh. 25% e njerëzve kanë ende kollë pas 3 javësh

Sëmundja (Illness)	Pjesët e prekura (Site)	Grupmosha (Age Group)	Shkaku (Cause)
Laringit	Kordat vokale	Fëmijët e mëdhenj / të rriturit	Virus
Krupe	Kordat vokale dhe laringu	Fëmijët e vegjël	Virus
Bronkit*	Tabat e frymëmarrjes (të mëdha)	Fëmijët e mëdhenj / të rriturit	Virus
Bronkiolit	Tabat e frymëmarrjes (të vegjël)	Të sapolindurit	Virus
Pneumoni	Qeset e ajrit	Të gjitha moshat	Bakter ose virus
Kollë e mirë	Nga hunda deri në mushkëri	Çdo moshë	Bakter

*Pacientët me sëmundje të rënda afatgjata të mushkërisë ndonjëherë marrin infektion bakterial kur preken nga bronkiti.

Menaxhimi: (Management:)

- Pini shumë lëngje, si p.sh., ujë.
- Supresantët e kollës mund të ndihmojnë fëmijët më të mëdhenj dhe të rriturit.


SHËNIM: Mos ua jepni këto produkte foshnjave ose fëmijëve nën moshën gjashtë vjeç.

SHËNIM: Shurupi për kollë mund të përmbajë gjithashtu mjekim për uljen e temperaturës. Lexoni me kujdes etiketat dhe konsultohuni me farmacistin ose mjekun tuaj për të shmangur mbidozën.

- Tabletat për kollë mund të ndihmojnë fëmijët më të mëdhenj dhe të rriturit. Shmangni tabletat antibakteriale të kollës sepse ato mund të çojnë në rezistencë ndaj antibiotikëve.

SHËNIM: Tabletat për kollë nuk duhet t'u jepen fëmijëve më të vegjël se gjashtë vjeç për shkak të rrezikut të mbytjes.

- Rekomandohet një radiografi e kraharorit për të diagnostikuar pneumoninë bakteriale. Pasi përcaktohet diagnoza, zakonisht jepen dhe antibiotikët me recetë.



Simptomat serioze që duhen kontrolluar nga një profesionist mjekësor

(Serious Symptoms That Should be Seen by a Medical Professional)



Këto simptoma kërkojnë vëmendjen e një mjeku ose infermieri.



Ethe: **(Fever:)**

- Nëse një fëmijë nën moshën 3 muajshe ka ethe, duhet kontrolluar menjëherë.
- Nëse një fëmijë i çdolloj moshe ka ethe dhe nuk ndihet mirë, duhet kontrolluar menjëherë.
- Nëse një fëmijë i çdolloj moshe ka ethe për më shumë se 3 ditë, duhet të kontrollohet brenda 24 orëve.

Vazhdim i pjesës "Simptomat serioze që duhen kontrolluar nga një profesionist mjekësor": (Serious Symptoms That Should be Seen by a Medical Professional Continued:)



Dhimbje veshi Konsultohuni me një mjek nëse fëmija ka dhimbje veshi dhe:
(Earache See a doctor if a child has an earache and:)

- Kanë temperaturë të lartë ose,
- Nuk duken mirë ose,
- Kanë skuqje ose ënjtje pas veshit ose,
- Veshi është i anuar përpara ose,
- Dhimbja e tyre e veshit mbetet e fortë për më shumë se 24 orë pavarësisht përdorimit të paracetomolit/ ibuprofenit.

Të rriturit me ethe ose me sëmundje të tjera duhet të konsultohen gjithmonë me mjekun ose infermierin e tyre nëse simptomat përkeqësohen ose janë shumë të rënda.

Në Alberta, mund të telefononi Health Link (në 811) nëse keni nevojë për këshilla ose jeni të pasigurt për mënyrën më të mirë të veprimit.

Për këshilla praktike mbi problemet e shëndetit të fëmijët, vizitoni [ahs.ca/heal](https://www.ahs.ca/heal), një burim informacioni publik i mirëmbajtur nga spitali "Stollery Children's Hospital".

Shenjat e emergjencave shëndetësore

(Signs of Health Emergencies)



Nëse ju ose dikush për të cilin po kujdeseni shfaq këto simptoma, kërkonte menjëherë kujdes mjekësor.



Ethe (Fever)

**Kërkonte kujdes të menjëhershëm mjekësor nëse:
(Seek immediate medical attention if:)**

- Një person i çdolloj moshe me ethe është shumë nervoz ose letargjik (vështirësi për t'u zgjuar ose për të qëndruar zgjuar), ka të vjella vazhdimisht dhe mund të ketë qafë të mpirë ose skuqje të madhe që nuk largohet kur ushtroni forcë mbi njolla (që mund të duken si të nxira të vogla).



Frymëmarrja (Breathing)

**Kërkonte kujdes të menjëhershëm mjekësor nëse:
(Seek immediate medical attention if:)**

- Një person i sëmurë i çdolloj moshe ka vështirësi në frymëmarrje (jo të shkaktuar nga një hundë e bllokuar).
- Një person i sëmurë po merr frymë shumë më shpejt ose më ngadalë se zakonisht ose i ka buzët, duart apo këmbët në ngjyrë blu.

Vazhdimi i pjesës "Shenjat e emergjencave shëndetësore": (Signs of Health Emergencies Continued:)



Gjendja e përgjithshme (General Condition)

Kërkoni kujdes të menjëhershëm mjekësor nëse: (Seek immediate medical attention if:)

- Një person i sëmurë i çdolloj moshe e ka të vështirë të zgjohet ose të qëndrojë zgjuar, ose është më konfuz, nervoz ose më i shqetësuar se normalisht, ka një dhimbje koke të fortë që nuk largohet, ka qafë të mpirë, ka lëkurë me shenja të kuqe ose shumë të zbehtë, ose është i ftohtë kur e prek.
- Një person i sëmurë ka shenja dehidratimi, të cilat përfshijnë lëkurë të thatë, gojë të thatë, një pjesë të butë te koka e foshnjës (fontanela), ose ka shumë pak urinë.

Arsyet e tjera për të kërkuar kujdes të menjëhershëm mjekësor përfshijnë:

(Other reasons to seek immediate medical attention include:)

- Nëse një person i sëmurë ka vështirësi në gëlltitje ose nxjerr shumë jargë.
- Nëse një person i sëmurë i çdolloj moshe ndihet i dobët, është i paaftë për të lëvizur ose ka kriza.

Ky informacion është dhënë vetëm si referencë. Në çdo kohë, ju duhet të përdorni njohuritë dhe gjykimin tuaj nëse ju duhet të flisni me një mjek, infermier apo infermier praktikues.

Në Alberta, mund të telefononi Health Link (në 811) nëse ju duhet këshillë ose jeni të pasigurt se cila është mënyra më e mirë e veprimit.

A e dinit se?

(Did you know?)

1. Larja e duarve është mënyra më e mirë për të ndaluar përhapjen e infeksioneve.
2. Bakteret dhe viruset janë të ndryshme. Të dyja mund të shkaktojnë infeksione, por antibiotikët veprojnë vetëm kundër infeksioneve bakteriale.
3. Përdorni antibiotikët në mënyrën e duhur për të kufizuar zhvillimin e rezistencës ndaj antibiotikëve.



**DO
BUGS
NEED
DRUGS?**



 **Alberta Health
Services**

"Do Bugs Need Drugs" është një program i "Alberta Health Services" dhe "British Columbia Centre for Disease Control"